



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 186/ 2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur, përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, paraqitur ndaj Ariana Elezit, për shkak të parregullsive gjatë procesit të zgjedhjeve në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Kaçanikut, në seancën e panelit të mbajtur me 21.06. 2012, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 18.06.2012, nga subjekti politik LVV, dega në Kaçanik, me të cilën pretendohet se me datën 17.06.2012 në shkollën “Skënderbeu” në vendvotimin VV 0701D/01R rreth orës 11:35 një person me emrin Ariana Elezi është lejuar të votoj për dy persona tjerë. Me këtë rast parashtruesi i ankesës pretendon se është shkelur Rregulla Zgjedhore 9/2009 neni 9 paragrafi 3 dhe neni 178 i Kodit penal të Kosovës. Parashtruesi i ankesës pretendon se më pas këto vërejtje janë shënuar në librin e vërejtjeve nga vëzhguesi ynë.

PZAP-i, e informoi nëpërmes postës elektronike Vedat Demën kryesuesin e vendvotimit 0701D/01R lidhur me ankesën e parashtruar nga subjekti politik LVV dhe kërkoi nga ai të përgjigjet në lidhje me ankesën në fjalë deri me datën 19.06.2012 në ora 15:00.

Po atë ditë pra me datën 19.06.2012, PZAP-i pranoi përgjigjen në ankesë nga personi në fjalë e ku në përgjigjen e tij thekson se ankesa e cila është bërë ka të bëjë me një vajzë që i ka asistuar dhe jo që ka votuar dy herë por i ka ndihmuar gjyshit dhe gjyshes së vet pasi që në raste të tilla familja më shumë i beson familjarit të vet se sa dikujt tjetër pasi që ata kanë qenë pleq dhe nuk kanë mundur të votojnë pa asistencë, prandaj për këtë rast se si kanë ndodhur janë njoftuar edhe zyrtarët e KQZ-së në Kaçanik.

PZAP-i, më datë 18.06.2012, ka kërkuar Librin e Votimit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për Vendvotimin 0701D/01R.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

Ankesa është e pabazuar.

Ankuesi në ankesë pretendon se në vendvotimin 0701D/01R, një person me emrin Ariana Elezi është lejuar të votoj për dy perona. PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë për faktin se nuk janë dhënë prova dhe dëshmi bindëse që do ti argumentonin pretendimet e tilla ankimore, pasi që nga deklarata e kryesuesit të vendvotimit dhe verifikimit nga ana e PZAP-it në Librin e Votimit për vendvotimin 0701D/01R në asnjë rast nuk është deklaruar nga askush se personi me emrin Ariana Elezi është lejuar që të votojë për dy persona tjerë ashtu siç pretendohet në ankesë. Prandaj një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si i pa bazë dhe i pa argumentuar në prova dhe në dëshmi bindëse, andaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 186/2012 më datën 21.06.2012.

Kryesuesi i panelit
Ymer Hoxha

